



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

---

**V E N D I M**

**PËR CAKTIMIN E VENDIT TË NUMËRIMIT TË VOTAVE TË ZAZ-SË NR. 80, QARKU GJIROKASTËR, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 30.06.2019**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e tij të datës 18.05.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI	Kryetar
Denar	BIBA	Zëvendëskryetar
Bledar	SKËNDERI	Anëtar
Edlira	JORGAQI	Anëtare
Rezarta	Bitri	Anëtare

shqyrtoi çështjen me:

**OBJEKT:** Caktimin e Vendit të Numërimit të Votave të ZAZ-së Nr. 80, Qarku Gjirokastrë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.

**BAZA LIGJORE:** Neni 23, pika 1, gërma "a", neni 93 dhe neni 94, pika 1, të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur si dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

**V Ë R E N**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me shkresën nr. 1567 prot., datë 20.03.2019, i është drejtuar Prefektit të Qarku Gjirokastrë, duke kërkuar paraqitjen e listës së plotë të objekteve brenda territorit të Qarkut Gjirokastrë që përmbushin kriteret e neneve 93 dhe 94 të Kodit Zgjedhor, të ndryshuar, dhe Udhëzimit të KQZ-së nr. 4, datë 9.04.2015. për caktimin e Vendeve të Numërimit të Votave, për shtatë (7) Zonat e Administrimit Zgjedhor.

Prefekti i Qarkut Gjirokastrë, me shkresat nr. 1567/1 prot, datë 26.04.2019, nr. 1567/2, datë 17.05.2019, i ka paraqitur KQZ-së propozimet për ambiente të cilat mund të shërbejnë si Vende të Numërimit të Votave për ZAZ-në Nr. 80, Qarku Gjirokastrë:

- Shkolla 9 vjeçare Jorgucat, ambienti me sipërfaqe 152 m<sup>2</sup>, Bashkia Dropull.
- Qendra e Kulturës, salla me sipërfaqe 200 m<sup>2</sup>, Grapsh, Bashkia Dropull.



**Nr. 520 i Vendimit    Data 18.05.2019 e Vendimit    Ora 12.<sup>00</sup> e vendimit**

Për caktimin e Vendit të Numërimit të Votave të ZAZ-së Nr.80, Qarku Gjirokastrë,  
për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019

Qendra e Kulturës, salla me sipërfaqe 200 m<sup>2</sup>, Grapsh, Bashkia Dropull, ka qenë Vend i Numërimit të Votave edhe në zgjedhjet e 2017. Ky objekt ndodhet brenda territorit të Zonës së Administrimit Zgjedhor, plotëson kriteret e parashikuara në nenin 93 dhe 94 të Kodit Zgjedhor, i ndryshuar, si dhe të Udhëzimit nr. 4, datë 9.04.2015, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve "Për mënyrën e caktimit dhe organizmit të Vendit të Numërimit të Votave, kriteret për caktimin e numrit të grupeve të numërimit për çdo vend të numërimit të votave, përcaktimin e rregullave për ndarjen e detyrave midis anëtarëve të grupeve të numërimit".

ZAZ-ja Nr. 80 ka në juridiksionin e saj 40 qendra votimi, dhe në bazë të përcaktimeve të Udhëzimit të KQZ-së nr. 04, datë 09.04.2015, ambienti i VNV-së duhet të ketë një sipërfaqe prej jo më pak se 150 m<sup>2</sup>.

### **PËR KËTO ARSYE**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 23, pika 1 germa "a", nenin 93 dhe 94, pika 1 të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar:

### **V E N D O S I**

1. Të caktojë Vendin e Numërimit të Votave të ZAZ-së nr. 80, në Qendrën e Kulturës, salla me sipërfaqe 200 m<sup>2</sup>, Grapsh, Bashkia Dropull.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda pesë ditëve nga shpallja e tij.

<b>Klement</b>	<b>ZGURI</b>	<b>Kryetar</b>
<b>Denar</b>	<b>BIBA</b>	<b>Zëvendëskryetar</b>
<b>Bledar</b>	<b>SKËNDERI</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Edlira</b>	<b>JORGAQI</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Rezarta</b>	<b>BITRI</b>	<b>Anëtare</b>



**Nr. 520 i Vendimit    Data 18.05.2019 e Vendimit    Ora 12.<sup>00</sup> e vendimit**

Për caktimin e Vendit të Numërimit të Votave të ZAZ-së Nr.80, Qarku Gjirokastrër,  
për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019